



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-24-0058

**Në ankesën e**

**Paditësi/Ankuesi**

**A C**, nga Prishtina, të cilin e përfaqësojnë H P dhe F P avokatë nga Prishtina.

**Kundër**

**E paditura**

**Autoriteti i Likuidimit i NSH "Rilindja" Gazeta** (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-17-0104 të datës 11 janar 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 02 gusht 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-17-0104 të datës 11 janar 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 05 qershor 2017, paditësi e ka dorëzuar një ankesë në DHPGJS dhe ka kërkuar që të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN142-0024 i datës 17 maj 2017, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e 3 pagave të papaguara nga NSH "Rilindja"- Gazeta (në likuidim) në shumë dhe periudhë të pacaktuar. Autoriteti i Likuidimit kishte konstatuar se paditësit nuk mundet t'i njihet e drejta në tri paga në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, pasi që paditësi nuk ka mbështet kërkesën për një detyrim të tillë të NSH-së, dhe nuk janë tri paga të fundit që mund të kenë mbetur të pa paguara. Autoriteti i Likuidimit konstaton se kërkesa është e parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Ankuesi në ankesë ka pohuar se vetë vendimi i Autoritetit të Likuidimit e konfirmon se kërkesa është dorëzuar në procedurën e likuidimit brenda afatit për dorëzimin e kërkesave dhe ky fakt nuk është kontestues. Tutje në ankesë paditësi pohon se në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së ai ka të drejtë në 3 paga të pa paguara, që janë kërkesa prioritare, andaj këto 3 paga duhet t'i paguhen secilit punëtorë. Në fakt paditësi me ankesë kërkon kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së Punës, duke i kërkuar 3 paga të fundit të pa paguara, në shumë prej 480.00 euro. Në ankesë ai ka pohuar se në NSH "Rilindja"- gazeta ka punuar, kur janë dëbuar kolektivisht nga puna punëtorët në mënyrë të dhunshme, të kundërligjshme dhe në mënyrë të pa drejtë. Në ankesë ai ka pohuar se dokumentet e tij i ka dorëzuar me datë 11 prill 2017 në procedurën e likuidimit. Bashkë me këtë ankesë e dërgon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe autorizimin e avokatit për përfaqësim.

Me datë 30 qershor 2017, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në padi. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se nuk ka asnjë kontradiktë në lidhje me konstatimet e Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se paditësi nuk ka përcaktuar saktë periudhën për të cilën kërkon kompensim të tri pagave të pa paguara dhe Autoriteti i Likuidimit e mori

për bazë deklaratën e tij të dorëzuar me kërkesën në likuidim, ku shprehej se kishte punuar për NSH-në deri me 21.02.2002, ndërsa asgjë nuk e ndalonte paditësin që më herët të kërkojë pagat e pretenduara ndaj NSH-së tek Gjykata kompetente. AKP-ja po ashtu pohon se neni 40.1.6.1 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së nuk parasheh njohje të garantuar të kompensimit me 3 paga të pa paguara, nëse ato nuk janë të fundit që mund të kenë mbetur të pa paguara. AKP-ja pohon se në çdo rast paditësi ishte i detyruar t'i mbështetë me prova se ajo kishte punuar në NSH dhe nuk është paguar, gjë që kjo nuk ka ndodhur. Tutje AKP-ja po ashtu pohon se paditësi nuk gëzon të drejtën e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës për shkak se nuk është dëshmuar se ndërprerja e punësimit të tij ka ndodhur si rezultat i një veprimi të AKP-së.

Me datë 17 korrik 2017, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në mbrojtje të AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i përsërit pretendimet e veta të cekura në ankesë se kërkesa për tri paga të pa paguara nuk mund të konsiderohet e parashkruar. Në këtë parashtresë ka kërkuar që të aprovohet ankesa si dhe i ka kërkuar shpenzimet e përfaqësimit prej 104 euro dhe kompensimin e taksave gjyqësore prej 40 euro.

Me datë 27 korrik 2017, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundër përgjigjen, në të cilën ajo i ka përsëritur pretendimet e veta të cekura në mbrojtjen në ankesë, Në këtë parashtresë ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me datë 11 janar 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-17-0104, ankesën e paditësit e refuzon si të pabazuar dhe vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se është i saktë përfundimi i Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për paga për periudhën e cekur tashmë është parashkruar, andaj saktë është refuzuar kërkesa si e pavlefshme. Tutje Shkalla e I-rë e DHPGJS-së arsyeton se ankuesi nuk ka ndërmarr ndonjë veprim para gjykatës apo Agjencisë për të kërkuar pagat, andaj nuk ka pasur ndërprerje të parashkrimit në kuptim të neneve 387 dhe 388 të LMD-së. Afati kohor për të cilën paditësi kishte kërkuar

pagat e pa paguara të vitit 2008 ka filluar të rrjedhë menjëherë pas këtij viti, andaj sipas nenit 372 paragrafi të LMD-së të vitit 1978, kërkesa është parashkruar. Padiësi nuk ka sjellë prova në gjykatë që lidhur me pagat e kërkuara ka paraqitur padi në gjykatë në periudhën e mëhershme, dhe ai nuk ka qenë i penguar që në procedurë gjyqësore ti kërkoj pagat.

Me datë 26 janar 2024, padiësi (në taksin e mëtejme ankuesi) në DHPGJS ka dorëzuar një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-17-0104 të datës 11 janar 2024, për të gjitha bazat ankimore dhe ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar, ose të anulohet Aktgjykimi dhe çështja të kthehet në riprocedurë për rigjykim. Për më tepër në ankesë ankuesi pretendon se Aktgjykimi i ankimuar nuk mund të ekzaminohet pasi që është kontradiktor në mes dispozitivit dhe arsyetimit, ai fare nuk ka arsye për faktet vendimtare dhe ato arsye që janë dhënë janë kontradiktore. Tutje ankuesi pretendon se padia është e dorëzuar brenda afatit dhe ajo duhet të konsiderohet si e afatshme. Ankuesi pohon se tek Autoriteti i Likuidimit janë kërkuar 3 pagat e papaguara, për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 480.00 euro. Fakti i punësimit të padiëses dhe i mos pagesës së këtyre pagave për këtë periudhë nuk kontestohet nga asnjëra parë por kontestohet vetëm parashkrimi. Qëndrimi ligjor i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, se kërkesa e ankuesit për këto 3 paga është parashkruar nuk është i saktë, pasi që në njoftimin e të paditurës e ka njoftuar padiësin se procesi i Likuidimit të NSH-së ka filluar me 22.02.2017 dhe në atë njoftim e paditura ka pohuar "se përkundër faktit që ju më parë keni njoftuar Agjencinë lidhur me pretendimin tuaj, ju përsëri duhet të parashtroni kërkesën lidhur me pretendimin tuaj pasi që tani kanë filluar procedurat e likuidimit për këtë ndërmarrje ". Tutje ai pohon se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka zbatuar gabimisht nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Ky ligj është i përgjithshëm dhe është i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit për ndërmarrjet. Ndërsa ligji i AKP-së dhe Shtojca e tij, është ligj special, rregullon procedurën e likuidimit dhe mënyrën e përmbushjes së kërkesave të kreditorëve dhe është i aplikueshëm në këtë rast. Tutje padiësi pohon se neglizhenca lidhur me fillimin e

procedurës së likuidimit të NSH-së nuk mundet t'i shërbejë të paditurës si alibi për të shmangur obligimin ligjorë për pagesën e pagave të ankueses, dhe kjo do të përbënte shkelje të drejtave themelore të punëtorëve në punë.

Me datë 06 mars 2024, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat, por jo edhe në arsyetimin ligjor.

Kolegji i Apelit vëren se çështja e parë që duhet definuar në këtë lëndë është se çka është duke kërkuar paditësi në Gjykatë, përkatësisht natyrën ligjore të kërkesës, nëse është duke kërkuar 3 paga të pa paguara për një periudhë që nuk është specifikuar, apo është duke kërkuar 3 paga në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjë që këto kërkesa për kahe natyra ligjore e tyre janë të dallueshme, dhe nuk ndërlidhen njëra me tjetrën.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensimin e tri pagave të papaguara e datës 11 prill 2017, me vendimin PRN142-0024 të datës 17 maj 2017, refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësi në ankesën e dorëzuar në DHPGJS me datë 05 qershor 2017, me të cilën ai e konteston vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN142-0024, i datës 17 maj 2017, në fakt e definon më saktë natyrën ligjore të kërkesës së tij, ai në këtë ankesë kërkon dëmshpërblim për shkak të largimit të tij nga puna. Kjo kërkesë përsëritet edhe në ankesën gjatë procedurës ankimore, dhe mund të konstatohet se paditësi është duke kërkuar nga Gjykata që të i njihet e drejta e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 480.00 euro, duke u bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka trajtuar si një kërkesë për paga të pa paguara duke vlerësuar se kjo kërkesë është parashkruar, në bazë të nenit 372 paragrafi 1 i LMD-së.

Kolegji i Apelit konstaton se nuk ishte i drejtë cilësimi juridik i natyrës ligjore të kërkesës, në fakt kërkesa nuk është për 3 paga të pa paguara për periudhën që nuk është definuar, por është kërkesë për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Andaj refuzimi i kërkesës mbi bazën e parashkrimit nuk ishte i drejtë nga ana e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, pasi që rasti në fjalë duke e ditur natyrën ligjore të kërkesës, nuk mund të thuhet se kërkesa është parashkruar.

Në këtë lëndë duhet vlerësuar nëse paditësi me provat e ofruara ka dëshmuar se i plotëson kriteret ligjore që të i njihet e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në bazë të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së.

Paditësi në ankesën e tij ka pretenduar se në NSH ka punuar deri me datë 21 shkurt 2002, mirëpo ai me provat e ofruara në Gjykatë ka dëshmuar se ishte punëtor i NSH-së, mirëpo me asnjë provë ai nuk ka dëshmuar se AKP-ja atij ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë veprim të saj si rezultat të procedurës së likuidimit të NSH-së, për të pasur të drejtë, që në bazë të nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, t'i njihet e drejta e kompensimit të 3 pagave në shumë prej 480.00 euro, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Barra e provës për të vërtetuar këtë fakt bie mbi paditësin. Paditësi e ka sjellë në gjykatë: vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, autorizimin për përfaqësim dhe asnjë provë tjetër, por jo edhe ndonjë njoftim të AKP-së që do të vërtetonte se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat i veprimit të AKP-së për shkak të fillimit të procedurave të likuidimit, ndaj NSH-së.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit vlerëson se Aktgjykimi i ankimuar ishte i saktë në rezultat, por arsyetimi ligjor i refuzimit të kërkesës nuk ishte i drejtë. Megjithatë për shkak të këtyre arsyeve, që u cekën në këtë Aktgjykim, paditësi në mungesë të provave të cilat nuk i ka sjellë në Gjykatë, ai nuk ka të drejtë kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së nr.04/L-034.

Sipas nenit 11 të Ligjit për DHPGJS-në, pala e pasuksesshme duhet t'i paguaj shpenzimet procedurale, përfshirë taksat gjyqësore të palës tjetër. Ankuesi në këtë çështje është palë e pasuksesshme, prandaj shpenzimet gjyqësore janë në barrë e tij.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

**Taksat gjyqësore**

Ankuesi në bazë të nenit 13.9 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22.03.2017, i zbatueshëm nga data 1 maj 2017, është i liruar nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore, pasi që vlera e kontestit është më pak se 1000 euro.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 02 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_